

KONTRATË PËR LËSHIMIN E INSTRUMENTIT FINANCIAR (GARANCI OFERTE)

KJO KONTRATË MIDIS PALËVE:

Shoqëria e Sigurimeve INTERSIG – Vienna Insurance Group, person juridik i regjistruar me Vendimin e Gjykatës nr 26103 dt.18.07.2001, K.Fiskal K12201002T me adresë Rr. Dritan HOXHA, Godina INTERSIG, TIRANË, përfaqësuar nga Zj.Fitnete SULAJ, banuese në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtëse pasaportës me nr. _____ që këtu më poshtë do të quhet INTERSIG;

dhe: Shoqëria e përcaktuar në garancinë bashkëngjitur që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që këtu më poshtë do të quhet "Debitori Kryesor".

OBJEKTI I KONTRATËS - Sigurimi i detyrimit që mund të lind në të ardhmen nga konfiskimi i Garancisë që INTERSIG ka lëshuar apo do të lëshojë për "Debitorin Kryesor" dhe në favor të personave të tretë, siç dhe përcaktohet në këtë kontratë.

BAZA LIGJORE - Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

VLEFSHMËRIA

- Fillon datën e skadimit të vlefshmërisë së ofertës, në datën dhe orën, që është caktuar nga Enti Prokurues për t'u paraqitur oferta.
- Kontrata zgjat deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së Formularit (Çertifikatës) së Garancisë ose në rast zbatimi nga INTERSIG të detyrimit përcaktuar në Garanci, deri në shlyerjen e plotë të të gjitha detyrimeve që lindin për "Debitorin Kryesor", siç dhe janë përcaktuar në këtë Kontratë.
- Zgjidhet në mënyrë të menjëhershme dhe pa kundërshtime ("ipso jure") kur "Debitori Kryesor", fitues i garës së tenderit, lidh kontratën e sipërmarrjes me Entin Prokurues.

PALËT SA MË SIPËR BIEN DAKORT SI VIJON:

NENI 1 – KUSHTET E KONTRATËS

- INTERSIG ka lëshuar për "Debitorin Kryesor" një Formular (Çertifikatë) Garancie sipas të dhënave në garancinë bashkëngjitur, në mbulim të përgjegjësisë së "Debitorit Kryesor" ndaj "Përfituesit të Garancisë".
- Vlera e garantuar nga INTERSIG do të jetë e shënuar në Formularin e Garancisë dhe do të jetë nga 2 deri 5% e fondit të prokuruar.
- INTERSIG detyrohet kundrejt "Përfituesit" (Entit Prokurues) të paguajë shumën për të cilën bëhet garant në rast se "Debitori Kryesor":
 - Tërheq ofertën e tij brenda periudhës së vlefshmërisë së kontratës;
 - Heq dorë nga lidhja e Kontratës, kur është shpallur fitues me vendim përfundimtar të entit prokurues;
 - Nuk paraqet garantimin e Kontratës, në se do të kërkohet.
- INTERSIG do të paguajë shumën e garantuar brenda afatit të 30 (tridhjetë) ditëve nga mbërritja e kërkesës së arsyetuar me shkrim nga "Përfituesi" (Enti Prokurues).

NENI 2 - "Debitori Kryesor" pranon përmbajtjen e Formularit (Çertifikatës)/ve të Garancisë dhe detyrohet të paguajë primin përkatës të sigurimit si dhe të përdorë Formularin (çertifikatën) e Garancisë për qëllimin e mirë për të cilin ai/ata lëshohet duke ju përmbajtur moralisht dhe ligjërisht të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i tij/tyre.

NENI 3 - INTERSIG ka të drejtën e rimbursimit nga "Debitori Kryesor" dhe/ose Dorëzanesi të çdo shume brenda vlerës së garantuar më sipër (neni 1) plus interesa, kamatvonesa

apo çdo shpenzim për rimbursimin e çdo shume që ai bëhet përgjegjës të paguajë në përputhje me detyrimet e parashikuara në Formularin (çertifikatën) e Garancisë. Në se "Debitori Kryesor" i ndodhur në faj, brenda afatit 10 ditor, nuk i paguan INTERSIG shumën e garantuar, "Debitori Kryesor" pranon detyrimin për të paguar për çdo ditë vonesë kamatën në masën 2% të shumës së garantuar, ose të pjesës së paguar.

NENI 4 - Në rast se Përfituesi paraqet kërkesë për konfiskim Garancie, "Debitori Kryesor" brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës do t'i paguajë INTERSIG, ose do të vendos si CASH kolateral në emër të tij çdo shume që INTERSIG bëhet përgjegjës të paguajë sipas përcaktimit në pikën 3 më sipër pavarësisht nëse INTERSIG ka kryer apo jo pagesë sipas detyrimeve të parashikuara në Formularin (Çertifikatën) e Garancisë.

NENI 5 - Dorëzanesi detyrohet t'i përgjigjet INTERSIG me kërkesën e parë me shkrim, pavarësisht nga aftësia paguese e "Debitorit Kryesor", për çdo shumë që sipas Formularit (Çertifikatës) së Garancisë, INTERSIG bëhet përgjegjës të paguajë.

NENI 6 - Duke paguar shumën apo çdo shumë brenda kufirit të shumës së përcaktuar në këtë Kontratë, INTERSIG do t'i kalojnë të drejtat e Përfituesit lidhur me shumën e garantuar sipas Formularit (Çertifikatës) së Garancisë, duke përfshirë këtu çdo mjet sigurimi dhe aksesorë të tjerë që sigurojnë pagimin e kësaj shume. Asnjë autoritet ose person nuk do të ndërmarrë ndonjë veprim për të paragjykuar këtë.

NENI 7 - Të gjithë detyrimet e çfarëdo natyre që INTERSIG duhet të përballojë për kthimin e shumës së garancisë së paguar janë në ngarkim të "Debitorit Kryesor".

NENI 8 - Pjesë integrale e kësaj Kontrate është Formulari (Çertifikata) e Garancisë objekt i kësaj Kontrate.

NENI 9 - Shtesa ose ndryshime të kësaj Kontrate bëhen me shkrim.

NENI 10 - Për çfarë nuk është përcaktuar shprehimisht në këtë Kontratë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Pjesa IV, mbi Detyrimet dhe Pjesa V Dorëzania.

NENI 11 - Në rast se ndonjë apo më shumë nga dispozitat e kësaj Kontrate dhe akteve të tjera të cilave kjo Kontratë i referohet shpallen apo mund të konsiderohen të pavlefshme, të paligjshme apo të pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave që mbeten nuk do të ndikohet. Palët në mirëbesim do të negociojnë për të zvendësuar dispozitat e kontestueshme me dipozita të vlefshme me efekte riparuese të përafërta me qëllimin e palëve të shprehur sipas kësaj Kontrate.

NENI 12 - Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve si rezultat i kësaj Kontrate zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13 - Kjo Kontratë lidhet sipas datës të përcaktuar në garanci, u përpilua me vullnetin e lirë të palëve dhe firmoset pa vërejtje nga palët.